- D) kodi kalorësiak për organizimin e ushtrisë mesjetare

260. Në shpejtimin e pushtimeve osmane ndikuan:

- A) epërsitë e fesë myslimane
- B) dobësia dhe mungesa e zhvillimit në shtetet fqinje
- C) epërsia organizative dhe ushtarake e shtetit të ri osman
- D) aleancat e fuqishme ndërmjet shteteve të tjera

261. Legjislacioni i dyfishtë ishte karakteristikë e:

- A) Perandorisë Bizantine
- B) Perandorisë Karolinge
- C) Perandorisë Osmane
- D) Perandorisë Habsburgase

262. Sheriati është baza ligjore që ka vepruar në:

- A) Perandorinë Osmane
- B) Perandorinë Romake
- C) Perandorinë Franke
- D) Perandorinë Perse

263. Baza ligjore kryesore në Perandorinë Osmane ishte:

- A) urdhërat e sulltanit
- B) e drejta zakonore
- C) kanunet
- D) sheriat

264. Organizimi shtetëror tipik tek popujt e Ballkanit në Mesjetë ishte:

- A) principata
- B) perandoria
- C) republika
- D) dinastia

265. Origjina e universiteteve evropiane datohet në epokën:

- A) antike
- B) mesjetare
- C) moderne
- D) bashkëkohore

266. Shteti i parë sllav që u krijua në Evropë ishte:

- A) shteti polak
- B) shteti rus
- C) shteti bullgar
- D) shteti serb

267. Krijimi i Perandorisë mesjetare Serbe u realizua nga:

- A) Stefan Nemani
- B) Stefan Uroshi
- C) Stefan Dushani
- D) Stefan Milutini

268. Mbretëria më e hershme tregtare afrikane në Mesjetë ishte ajo e:

- A) Ganës
- B) Malit
- C) Sudanit Perëndimor
- D) Bantusë

269. Në Japoni pushteti ushtarak i përkiste:

- A) perandorit
- B) daimjuve
- C) dinastëve
- D) shogunit

270. Mbështetja ushtarake e shogunit në Japoni ishin:

- A) samurajt
- B) daimjutë
- C) hanët
- D) jeniçerët

271. Eksploruesit e parë evropianë që nisën zbulimet gjeografike dhe gjetën të parët rrugën për në Indi ishin:

- A) spanjollët
- B) anglezët
- C) portugezët
- D) italianët

272. Eksploratori i parë që lundroi nga Perëndimi në Lindje dhe kreu i pari udhëtimin përreth botës ishte:

- A) Kristofor Kolombi
- B) Amerigo Vespuçi
- C) Ferdinand Magelani
- D) Vasko de Gama

273. Perandori i nëntë dhe i fundit i Perandorisë Acteke ishte:

- A) Temujini
- B) Montezuma II
- C) Tenoktilani
- D) Kuzko

274. Perandoria Acteke dhe Perandoria Inkase u bënë koloni të:

- A) portugezëve
- B) hollandezëve
- C) anglezëve
- D) spanjollëve
- E) italianëve

275. Kryqëzatat ishin:

- A) fushata ushtarake me karakter fetar, ekonomik dhe politik
- B) përpjekje për reformimin moral të Kishës Katolike
- C) përpjekje për reformimin moral të Kishës Ortodokse Lindore
- D) mosmarrëveshje doktrimore midis Kishës Katolike dhe Kishës Ortodokse

276. Sistemi i përgjithshëm gjyqësor për gjithë Anglinë u krijua në sundimin e:

- A) mbretit Riçard Zemërluanit
- B) mbretit Eduard
- C) mbretit Henri I
- D) mbretit Xhonit “*pa tokë*”

277. “*Trëndafili i kuq*” në Anglinë mesjetare ishte një grupim:

- A) i zejtarëve dhe tregtarëve
- B) i feudalëve të Jorkëve
- C) i feudalëve të Lankasterëve
- D) i kalorësve ushtarakë anglezë

278. “*Trendafili i bardhë*” në Anglinë e mesjetës ishte një grupim:

- A) i fisnikërisë së re ushtarake
- B) i feudalëve të Lankasterëve
- C) i zejtarëve dhe tregtarëve
- D) i feudalëve të Jorkëve

279. Reformacioni Protestant në Gjermani lidhet me emrin e:

- A) Ulrich Cvinglit
- B) Zhan Kalvinit
- C) Tomas Myncerit
- D) Martin Luterit

280. Hugnotët në Francë ishin përkrahës të:

- A) Katolicizmit
- B) Calvinizmit
- C) Kundërreformacionit
- D) Ortodoksisë

281. Ligji i Supremacisë i vitit 1534 në Angli shpalli:

- A) amnistinë për kundërshtarët politikë të mbretit
- B) privilegje të veçanta për fisnikërinë
- C) barazinë e besimeve fetare para ligjit
- D) mbreti do të ishte në krye të Kishës Anglikane

282. Koncili i Trentos i vitit 1545 lidhet me:

- A) Reformacionin Protestant
- B) Reformacionin Katolik
- C) Revolucionin e “Çmimeve”
- D) Revolucionin Gregorian

283. Paqja e Vestfalisë e vitit 1648 shënon fundin e:

- A) Luftës 100 – vjeçare
- B) Luftës 7 – vjeçare
- C) Luftës 30 – vjeçare
- D) Luftës së “*Trëndafilave*”

284. “*Peticioni mbi të drejtat*” në Angli në 1688:

- A) vendosi kryerjen e reformës së kishës në Angli
- B) vendosi të krijohej komiteti i Rezistencës i fisnikëve anglezë
- C) kërkoi ndalimin e arrestimeve pa një vendim gjyqsor
- D) kërkoi ndalimin e procesit të gardhimeve

285. Parlamenti i Gjatë në Angli:

- A) deklaroi se mund të shpërndahej vetëm me vullnetin e vet
- B) i njohu mbretit të drejtën të mbajë ushtri
- C) solli në fronin e Anglisë mbretin Eduardin
- D) deklaroi se mbreti ishte i detyruar të mbledhë parlamentin tre herë në vit

286. Presbiterianët në Angli kishin si program:

- A) ndalimin e gardhimeve dhe kthimin e fshatarëve në ngastrat e gardhuara
- B) rrëzimin e mbretit dhe vendosjen e republikës
- C) shërndarjen e dhomës së lordëve
- D) shërndarjen e ushtrisë së parlamentit dhe ruajtjen e monarkisë

287. Independentët në Angli kishin në programin e tyre:

- A) krijimin e një republike parlamentare me të drejtë të gjerë elektorale
- B) ruajtjen e mbretërisë së kufizuar parlamentare
- C) të drejtën e mbretit për një ushtri të përhershme
- D) thellimin e procesit të gardhimeve

288. E vetmja kushtetutë e shkruar në Angli e miratuar nga Oliver Kromwell është emërtuar:

- A) “*Deklarata e të Drejtave*” (Bill of Rights) (1689)

- B) “*Instrumenti i administrimit*”
- C) “*Magna Charta*” (Karta e Madhe e Lirive)
- D) “*Akti mbi trashëgimin e fronit*” (Act of Settlement)

289. Miratimi i “*Habeas Corpus Act*” në Angli:

- A) sanksionoi të drejtat e parlamentit anglez
- B) siguronte paprekshmërinë personale të personit
- C) kufizoi të drejtat e parlamentit
- D) krijoi ushtrinë e rregullt mbrëtërore

290. “*Deklarata e të Drejtave*” (Bill of Rights) (1689):

- A) i njeh mbretit të drejtën që të mbajë një ushtri të përhershme
- B) ndaloi mbretin që të nxjerrë ligje pa u miratuar në parlament
- C) detyronte personat zyrtarë të bënin betim para mbretit
- D) vendosi në Angli monarkinë kushtetuese

291. “*Deklarata e të Drejtave*” (Bill of Rights) (1689):

- A) krijoj sistemin dydhomësh të parlamentit anglez
- B) përjashtoi katolikët nga e drejta e fronit
- C) sanksionoi të drejtën e qytetarëve të drejtojnë peticione mbretit
- D) vendosi të drejtën e përgjithshme elektorale në Angli

292. “*Act of Settlement*” (Akti mbi trashëgiminë e fronit) parashikonte:

- A) fronti mbretwror i kalon pasardhësit më të afërt protestant të mbretit
- B) sanksionoi të drejtën e shtetasve anglezë të drejtojnë peticione mbretit
- C) pezulloi nxjerrjen e ligjeve nga parlamenti
- D) i sanksionoi parlamentin të drejtën e vendosjes së taksave

293. “*Akti mbi trashëgimin e fronit*”:

- A) shpalli lirinë e katolicizmit në Angli
- B) shpalli dëbimin jashtë Anglisë të gjithë katolikëve
- C) përjashtoi nga trashëgimi i fronit çdo katolik dhe personat e martuar me katolik
- D) zgjeroi më tej pushtetin ligjvënës të mbretit

294. Revolucioni i Lavdishëm i vitit 1688 në Angli:

- A) solli në pushtet diktaturën e Kromwellit
- B) përmbysi dinastinë e Stjuartëve
- C) përmbysi monarkinë dhe shpalli republikën
- D) solli krijimin e perandorisë së parë angleze

295. Fronda parlamentare në Francë në vitin 1648 -1649:

- A) miratoj reformën financiare në Francë
- B) i imponoi monarkisë reformat e miratuara nga parlamenti i Parisit
- C) autorizoi zëvendësimin e monedhës së arit me kartëmonedhë

D) autorizoi përdorimin e dhunës ndaj kundërshtarëve të mbretit

296. Me reformat e parlamentit të Parisit të imponuara nga Fronda Parlamentare:

- A) u unifikua legjislacioni i Francës
- B) u zgjeruan pushtetet e mbretit
- C) nxjerrja e taksave do të bëhej nga mbreti
- D) u hoqën shumica e mbikqyrësve të mbretit

297. Në Gjermaninë feudale:

- A) perandori ruante pushtetin gjatë gjithë jetës së tij
- B) perandori kishte një mandat 7 vjeçar
- C) perandori zgjidhej me zgjedhje të drejtpërdrejta nga populli
- D) perandori zgjidhej nga mbledhja e dy dhomave të parlamentit

298. Në Gjermaninë e shekullit XVII organi që zgjidhte perandorin ishte:

- A) mbledhja e përbashkët e dy dhomave të parlamentit
- B) kongresi i princave të mëdhenj (kyrfyriste)
- C) Kuria e dytë
- D) Kuria e tretë

299. Synimi kryesor i politikës së jashtme të shtetit Prusian ishte:

- A) bashkëpunimi me shtetet fqinje
- B) respektimi i marrëveshjeve dhe traktateve ndërkombëtare. u krijua nga gjykata perandorake
- C) zgjerimi i tokave në kurriz të shteteve fqinje
- D) kundërshtimi i politikës franceze

300. Me cilin nga traktatet Habsburgët morrën nga Turqia Hungarinë Lindore dhe Transilvaninë:

- A) traktati i Ahenit
- B) traktati i Pazhorevacit
- C) traktati i Verdunit
- D) traktati i Karlovacit

301. Me reformën gjyqsore të Habsburgëve:

- A) funksionet gjyqsore u shpallën e drejtë vetëm e shtetit
- B) u krijua gjykata perandorake
- C) u forcuan dhe më shumë gjyqet kishtarë
- D) u krijuan gjykata të posaçme të provincave

302. Reformat e Pjetrit të Madh në Rusi:

- A) bënë refomimin e kishën ortodokse ruse
- B) përgatitën terrenin oksidentalizimin e Rusisë
- C) zgjeruan kompetencat e Zemskie Sobori (parlamenti rus)

D) ndryshoi struktura e qeverisë ruse

303. Sistemi i timarit i vendosur nga Perandoria Osmane në Ballkan:

- A) vendosi një formë të pronës feudale ushtarake
- B) bëri një ndarje të re administrative të perandorisë
- C) ndau perandorinë turke në katër ejalete
- D) krijoi sanxhakun si njësi administrative

304. Atdheu i Revolucionit të Parë Industrial ishte:

- A) Austria
- B) Gjermania
- C) Italia
- D) Anglia

305. Në vitin 1609 pavarësia e Provincave të Bashkuara u njoh nga mbreti i:

- A) Spanjës
- B) Anglisë
- C) Suedisë
- D) Francës

306. Njësia më e vogël administrative e Perandorisë Osmane me reformën administrative të shekullit XVI ishte:

- A) kazaja
- B) sanxhaku
- C) nahija
- D) timari

307. Në krye të çdo kolonie në Amerikën e Veriut ishte:

- A) guvernatori
- B) lordi
- C) senatori
- D) princi

308. Me dekretin e mbretit anglez Xhorxhit III në 1763:

- A) kolonitë e Amerikës fituan autonomi më të madhe
- B) u ndaluan kolonistët që të pushtonin toka të reja dhe të kalonin përtej Apasheve
- C) kolonitë fituan të drejtën të përfaqësohen në parlamentin anglez
- D) guvernatorët morën fuqi më të mëdha pushteti në koloni

309. Deklarata e Pavarësisë e SHBA:

- A) sanksionon të drejtën e popullit të ndryshojë qeverinë e tij
- B) përcaktoi formën e shtetit amerikan
- C) përcaktoi organet kryesore të shtetit amerikan
- D) përfaqëson kushtetutën e parë të Amerikës

310. Në deklaratën e pavarësisë të SHBA u shpall:

- A) që kolonitë do të kishin përfaqësuesit e vet në parlamentin anglez
- B) kolonitë e Amerikës Veriore të fitonin autonominë
- C) qeveria krijohet në bazë të kontratës e detyrohet të mbrojë të drejtën natyrore
- D) që SHBA do të jetë monarki parlamentare

311. Bazuar në kushtetutën e 1787 të SHBA:

- A) parlamenti amerikan, Kongresi, përbëhet nga dy dhoma
- B) në shtetet e Amerikës Veriore hiqej skllavëria
- C) SHBA janë republikë parlamentare
- D) feja katolike shpallet fe zyrtare

311. Forma e organizimit shtetëror e SHBA është:

- A) republikë parlamentare
- B) monarki konstitucionale
- C) republikë presidenciale
- D) monarki liberale

312. Kushtetuta e 1787 përcakton se pushteti ekzekutiv i përket:

- A) kryeministrit
- B) kongresit
- C) senatit
- D) presidentit

313. Sistemi politik i SHBA është:

- A) centralizëm politik
- B) federalizmi dhe autonomia e shteteve
- C) despotizmi i shtetit federal
- D) liberalizmi rajonal

314. Me miratimin e kushtetutës së vitit 1791 në Francë u vendos:

- A) republika parlamentare
- B) republika kushtetuese
- C) monarkia kushtetuese
- D) perandoria parlamentare

315. Përfaqësuesit e shtresës së tretë në Përfaqësitë e Përgjithshme në Francë kërkonin:

- A) votim të përgjithshëm
- B) votim në bazë të rendeve
- C) votim të drejtpërdrejtë
- D) votim për “kokë”(çdo deputet një votë)

316. Kuvendi i përfaqësuesve të rendit të tretë në Francë u quajt:

- A) asambleja nacionale
- B) asambleja legjislativ
- C) asambleja kushtetuese
- D) kuvendi legjislativ

317. Njësia administrative e Francës me reformën administrative të 1790 ishte:

- A) rajoni
- B) prefektura
- C) departamenti
- D) kantoni

318. Mandati i Asamblesë legjislativ sipas kushtetutës së 1791 në Francë ishte:

- A) dy vjet
- B) katër vjet
- C) pesë vjet
- D) një vit

318. Bazuar në kushtetutën e 1791 në Francë ministrant caktohen:

- A) nga asambleja
- B) nga perandori
- C) nga mbreti
- D) nga senati

319. Sipas kushtetutës së 1791 në Francë Asambleja legjislativ:

- A) ishte njëdhomësh
- B) ishte dydhomësh
- C) ishte e përjetshme
- D) caktohej nga mbreti

320. Grupimi politik jakobin në Francë:

- A) ishte për të drejtën e përgjithshme të votës
- B) kërkonte shpërndarjen e asamblesë legjislativ
- C) kërkonte ruajtjen e monarkisë
- D) ishte kundër shpalljes së republikës

321. Grupimi politik jakobin në Francë:

- A) kërkonte rrëzimin e monarkisë dhe shpalljen e republikës
- B) ishte për shpalljen e monarkisë kushtetuese
- C) mbështeste krijimin e një perandorie të centralizuar
- D) ishte për një monarki liberale parlamentare

322. Konventa Kombëtare e 21 shtatorit 1792 në Francë:

- A) krijoi Komunën e Parisit
- B) rivendosi monarkinë në Francë

- C) rrëzoi monarkinë dhe shpalli republikën
- D) riorganizoi parlamentit e Francës

323. Nën sundimin e Konventës Kombëtare në Francë sundonte:

- A) partia e jakobinëve
- B) partia e zhirondinëve
- C) montanjarët
- D) levelerët

324. Me dekretin e 17 qershorit në Francë:

- A) likujdohen pa shpërblim të gjitha detyrimet feudale
- B) u bë ndarja e tokave të emigrantëve
- C) u fajësuan jakobinët për dënimin e të burgosurve
- D) u arrestuan udhëheqësit zhirondinë

325. Qeveria e re jakobine e Robespierit u emërtua:

- A) Komiteti Kombëtar
- B) Këshilli Ekzekutiv
- C) Komiteti i Shpëtimit Shoqëror
- D) Këshilli Nacional

326. Dantonistët përbëjnë:

- A) krahun e majtë të grupit të jakobinëve
- B) krahun e djathtë të jakobinëve
- C) janë grupi i qendrës së jakobinëve
- D) përbëjnë kundërshtarët radikalë të jakobinëve

327. Me dekretet e Vantozës:

- A) pasuria u merrej armiqve të revolucionit dhe u jepej përkrahësve të tij
- B) zevendësohen oficerët fisnikë me oficerë nga shtresat e ulta
- C) vendosen çmimet maksimale të drithit
- D) u krijua Gjyqi i Jashtëzakonshëm

328. Me kushtetutën e 1795 në Francë:

- A) u rivendos monarkia në Francë
- B) doli jashtë ligjit partia Jakobine
- C) u vendos diktatura jakobine
- D) e drejta e votës i u njoh vetëm pronarëve të tokës dhe paguesve të një takse

329. Sipas kushtetutës së vitit 1795 pushteti ekzekutiv i përket:

- A) mbretit
- B) senatit
- C) direktoratit
- D) perandorit

330. Emri i parlamentit francez sipas kushtetutës së 1795 në Francë është:

- A) Asamble kombëtare
- B) Trup legjislativ
- C) Tribunat
- D) Këshilli i shtetit

331. Dhoma e lartë e Trupit Legjislativ në kushtetutën e 1795 ishte:

- A) këshilli i pleqve (250-tëve)
- B) këshilli i 500 – tëve
- C) këshilli i shtetit
- D) këshilli nacional

332. Parlamenti francez me kushtetutën e 1799 ishte:

- A) asambleja nacionale
- B) asambleja kushtetuese
- C) korpusi legjislativ
- D) këshilli kombëtar

333. Dhoma e ulët e korpusit legjislativ sipas kushtetutës së 1799 në Francë ishte:

- A) tribunati
- B) këshilli i pleqve
- C) senati
- D) direktorati

334. Dhoma e lartë e korpusit legjislativ sipas kushtetutës së 1799 në Francë ishte:

- A) këshilli i 250 – tëve
- B) trupi legjislativ
- C) tribunati
- D) дума

335. Me grushtin e shtetit të 18 brymerit 1799 në Francë:

- A) krijohet Komteti i Shpëtimit Publik
- B) arrestohen udhëheqësit zhirondinë
- C) përmbysen diktatura jakobine
- D) shpërndahen Direktorati dhe pushteti ekzekutiv u kalon tre konsujve

336. Në vitin 1804 senati francez vendosi:

- A) t'i japë Napoleon Bonapartit titullin “*Perandor i trashëgueshëm*”
- B) Të miratojë “Deklaratën e të Drejtave”
- C) të miratojë të drejtën e përgjithshme elektorale
- D) t'i japë fund pushtetit të Direktoratit

337. Me reformën ushtarake të Bonapartit:

- A) oficerët fisnikë zëvendësohen me oficerë nga shtresat e ulta
- B) pranohen në shërbim ushtarak vetëm pronarët e një ngastre
- C) futet sistemi i dërgimit të bedeleve në ushtri
- D) njësia më e vogël e ushtrisë franceze u caktua divizioni

338. Me të ashtuquajturën “*Karta e Dhuruar*” e vitit 1814 në Francë:

- A) vendoset monarkia kushtetuese me të drejta të gjera për mbretin
- B) u vendos republika perandorake
- C) rivendoset monarkia absolute
- D) rivendoset regjimi i direktoratit

339. Pushteti legjislativ sipas kushtetutës së 1814 në Francë i përket:

- A) parlamentit
- B) mbretit dhe parlamentit
- C) vetëm mbretit
- D) asamblesë nacionale

340. Anëtarët e dhomës së lartë të parlamentit sipas kushtetutës së 1814:

- A) zgjidhen nga dhoma e deputetëve
- B) zgjidhen nga një asamble kombëtare
- C) caktohen nga mbreti
- D) zgjidhen direkt nga populli

341. Sipas kushtetutës së 1814 mbreti i Francës:

- A) gëzonte të drejtën e vetos ndaj ligjeve të parlamentit
- B) ushtronte pushtet të drejtpërdrejtë legjislativ
- C) nuk gëzon të drejtën e shpalljes së ligjeve
- D) mbreti caktohej nga mbledhja e përbashkët e dy dhomave të parlamentit

342. Dhoma e lartë e parlamentit francez në kushtetutën e 1814 ishte:

- A) senati
- B) dhoma e perëve
- C) këshilli i pleqve
- D) tribunati

343. Me anë të ashtuquajturës “Bllokada Kontinentale” nga N.Bonaparti:

- A) arrihet shkatërrimi i flotës angleze në betejën e Kadiksit
- B) shkatërrohet flota franceze në betejën e Abukirit
- C) ndalohen aleatët e Francës të bëjnë tregti me Anglinë
- D) u bllokua flota angleze nga aleatët e Francës në La Mansh

344. Kongresi i Vjenës i vitit 1814:

- A) rrëzoi perandorinë franceze të N.Bonapartit
- B) bëri ndryshime në hartën politike të Europës

- C) vendosi izolimin e shtetit francez dhe copëtimin e tij
- D) i dha fund luftës midis Francës dhe Ruisë

345. “Lidhja e Shenjtë” e krijuar në Paris në 1815:

- A) ishte aleancë e shteteve evropiane kundër çdo lëvizje për një regjim demokratik
- B) ishte aleanca e Bonapartit me shtetet evropiane kundër Anglisë
- C) ishte aleanca e gjithë shteteve evropiane kundër N.Bonapartit
- D) ishte aleanca e “bllokut perëndimor” kundër “bllokut lindor”

346. Me kushtetutën e vitit 1814 në Francë pushteti ekzekutiv i përket:

- A) direktoratit
- B) mbretit
- C) dhomës së perëve
- D) presidentit

347. Zgjedhja e presidentit në Francë bazuar në kushtetutën e vitit 1848 bëhej:

- A) nga Këshilli i Shtetit
- B) me votim të përgjithshëm të drejtpërdrejtë
- C) nga Asambleja Kushtetuese
- D) nga mbledhja e përbashkët e dhomave të parlamentit

348. Me grushtin e shtetit të 2 dhjetorit 1851 u vendos në Francë:

- A) diktatura jakobine
- B) vijnë në pushtet zhirondinët, përkrahësit e monarkisë
- C) perandoria e dytë e Bonapartit
- D) perandoria e parë e Bonapartit

349. Në përfundim të luftës Franko – Prusiane të vitit 1870:

- A) përbyset perandoria e dytë e Bonapartit në Francë
- B) shpartallohet tërësisht shteti Prusian
- C) bëhet bashkimi i shteteve gjermane
- D) krijohet koalicioni i shteteve evropiane kundër perandorisë franceze

350. Asambleja franceze e 8 shkurtit të vitit 1871:

- A) vendosi të mos lëshojë Alsas – Lorenën Gjermanisë
- B) nënshkroi paqen me kushtet e ofruara nga Bismarku
- C) nuk pranoi ndryshimin e kufijve të Francës
- D) nuk pranoi të paguaj dëmshpërmbim Gjermanisë

351. Reforma kryesore e konservatorëve në Angli e vitit 1830:

- A) reforma elektorale
- B) reforma e çmimeve të drithit
- C) reforma arsimore
- D) liberalizimi i doganave

352. Lëvizja më e fuqishme që tronditi Anglinë në vitet 1840 -1850 ishte:

- A) lëvizja baptiste
- B) lëvizja gardhimeve
- C) lëvizja levelere
- D) lëvizja çartiste

353. Detyra kryesore e parlamentit të Frankfurtit të vitit 1848 ishte:

- A) miratimi i një deklaratë të drejtash
- B) miratimi i kushtetutës së Gjermanisë
- C) miratimi i reformës elektorale
- D) miratimi i reformës ekonomike

354. Formimi i perandorisë gjermane në janar 1871 u realizua nga:

- A) Meterniku
- B) Hitleri
- C) Geringu
- D) Bismarku

355. Regjimi i censure, spiunimit, survejimit e ndjekjes policore në Austri në shekullin XIX u vendos nga:

- A) Meterniku
- B) Klodvigu
- C) Bismarku
- D) Redecki

356. Monarkia dualiste e Austro – Hungarisë u krijua në vitin:

- A) 1826
- B) 1864
- C) 1866
- D) 1867

357. Në paqen e Parisit për luftën e Krimesë (lufta e Anglisë e Francës me Rusinë):

- A) u vendos që zona e Detit të Zi të shpallej asnjëanëse
- B) u vendos që Rusia të merrte Moldavinë dhe Vllahinë
- C) u vendos protektorati anglez dhe francez mbi Sevastopolin
- D) u vendos që Turqia të lëshoj ngushticën e Dardaneleve

358. Lufta e Bismarkut kundër kishës katolike në Gjermani në vitet 1872 -75 u quajt:

- A) mainkamf
- B) kulturkamf
- C) arbitkamf
- D) luteran kamf

359. Me kushtetutën e vitit 1875 Franca shpallet:

- A) republikë parlamentare
- B) monarki kushtetuese
- C) monarki absolute
- D) monarki parlamentare

360. Përkrahësit e republikanizmit në Francën e vitit 1870 ishin:

- A) kalorësit
- B) fisnikëria e re
- C) katolikët
- D) banorët e qendrave të vogla dhe fshatarët

361. Lëvizja e studentëve rusë kundër carit në fund të shekullit XIX ishte lëvizja:

- A) narodnike
- B) menshevike
- C) bolshevike
- D) esereve

362. Menshevikët rusë:

- A) kërkonin formimin e shoqërisë parlamentare me rrugë parlamentare
- B) ishin për përmbysjen e carizmit me revolucion
- C) ishin një grupim radikal marksist në Rusi
- D) përbënin një grup terrorist rus

363. Rretho pohimin e saktë: Bolshevikët rusë:

- A) ishin një grupim liberal marksist
- B) ishin udhëheqësit e lëvizjes narodnike
- C) kërkonin përmbysjen me dhunë revolucionare të carizmit në Rusi
- D) kërkonin kalimin në shoqërinë socialiste me rrugë parlamentare

364. Rreziku më i madh në perandorinë Austro - Hungareze ishin:

- A) prirjet dhe veprimet nacionaliste
- B) politika e jashtme agresive e perandorisë Austro – Hungareze
- C) politika antiaustriake e shtetit të bashkuar gjerman
- D) mosmarrëveshjet austriako hungareze

365. Reforma e Tanzimatit e shekullit XIX vendosi që:

- A) të shpëndahet korpusi i jeniçerëve
- B) kontigjenti i ushtarëve të çdo krahine të ishte në raport me popullsinë
- C) të krijohet flota ushtarake detare e perandorisë
- D) të krijohet garda kalorsiake e perandorisë turke prej 6000 vetësh

366. Dekreti i Sulltanit i vitit 1856 i quajtur “*Hati Humajun*”:

- A) kërkonte nga çdo kaza 1000 ushtarë

- B) shpërndau korpusin e jeniçerëve
- C) mbylli shkollat me prirje oksidentale
- D) sanksionoi barazinë e të drejtave të myslimanëve e jomyslimanëve

367. Turqit e rinj kërkonin:

- A) shërndarjen e parlamentit turk dhe forcimin e absolutizmit
- B) kthimin e perandorisë turke në monarki kushtetuese
- C) pezullimin e reformave decentralizuese të perandorisë
- D) mbylljen e shkollave me orientim oksidental

368. Programi i principatës serbe për krijimin e shtetit të madh serb u quajt:

- A) “Gllasnost”
- B) “Narodnaja”
- C) “Nacertania”
- D) “Vlladikos”

369. Vendi i parë ballkanik që u shkëput nga Perandoria Osmane ishte:

- A) Greqia
- B) Rumania
- C) Bullgaria
- D) Serbia

370. Kriza Lindore:

- A) lindi nga lufta e popujve të ballkanit dhe ndërhyrja e fuqive të mëdha në Ballkan
- B) pati si pasojë forcimin e Perandorisë Osmane
- C) ngadalësoi fitoren e pavarësisë nga popujt e ballkanit
- D) pati si pasojë dobësimin e ndikimit të fuqive të mëdha në Ballkan

371. Traktati i Shën Stefanit:

- A) vendosi dhënien e autonomisë nga Turqia të tokave shqiptare
- B) i dha Greqisë Shqipërinë e Jugut
- C) vendosi krijimin e një shteti të madh bullgar
- D) mori vendime në favor të perandorisë Austro-Hungareze

372. Reforma administrative e 1864 e Portës së Lartë njësinë më të madhe administrative e emërtoi:

- A) vilajeti
- B) ejaleti
- C) sanxhaku
- D) provinca

373. “Amerika për amerikanët” është politikë e SHBA e ndjekur nga presidenti:

- A) Linkoln
- B) gjenerali Ullis Gard

- C) Monro
- D) Ford

374. Vendimet më të rëndësishme i prezantohen Konferencës së Paqes së Versajës nga:

- A) këshilli i të dhjetëve
- B) asamblea e Versajës
- C) sekretariati i konferencës
- D) këshilli të katërve

375. Konferenca e Versajës:

- A) vendosi që Gjermania mund të mbante deri në 100.000 ushtarë
- B) i ktheu Shqipërisë tokat e pushtuara nga ushtria serbe
- C) vendosi zgjerimin dhe forcimin e perandorisë gjermane
- D) vendosi ti njohë Turqisë të drejtën e mbajtjes së flotës luftarake në Detin e Zi

376. Propozimi amerikan i “14 pikave” për marrëdhëniet e reja ndërkombëtare u bë nga:

- A) presidenti Ajzenhauer
- B) presidenti Ruzvelt
- C) presidenti Uilson
- D) Monro

377. Forma kryesore e regjimit politik që u zhvillua pas Luftës I Botërore ishte:

- A) monarkia konstitucionale
- B) regjimet diktatoriale
- C) regjimet socialiste
- D) republikat demokratike parlamentare

378. Britania e Madhe pas Luftës I Botërore ishte:

- A) monarki parlamentare
- B) monarki kushtetuese
- C) republikë parlamentare
- D) republikë presidenciale

379. Rretho pohimin e saktë:Konferenca e Mynihut e vitit 1938:

- A) krijoi bllokun e Antantës kundër Bashkimit Sovjetik
- B) ndaloi në Gjermani shërbimin e detyrueshëm ushtarak
- C) u hapi rrugë kërkesave revanshiste të Gjermanisë
- D) krijoi frontin perëndimor anti – turk

380. Në Republikën Franceze të pasluftës I Botërore presidenti i Francës zgjidhej:

- A) nga dhoma e deputetëve
- B) drejtpërdrejtë nga populli
- C) nga senati
- D) nga mbledhja e përbashkët e dy dhomave

381. Në programin prej 14 pikash të presidentit Uilson:

- A) u kërkua të hiqej dorë nga marrëveshjet e fshehta ndërkombëtare
- B) të zgjerohej sistemi kolonial
- C) të copëtohej perandoria gjermane
- D) të favorizohej politika revanshiste gjermane

382. Fuqia e madhe botërore që nuk hyri në “*Lidhjen e Kombeve*” ishte:

- A) Gjermania
- B) SHBA
- C) Anglia
- D) Franca

383. Kursi i ndjekur nga presidenti amerikan Warren G. Harding u quajt:

- A) reformizmi
- B) konservatorizëm
- C) kursi i ri
- D) zhvillimi i ri

384. Programi antikrizë i presidentit amerikan Ruzvelt u emërtua:

- A) kursi i ri
- B) programi i ri i zhvillimit
- C) kursi konservator
- D) progresi ekonomik

385. Akti Vagner në SHBA:

- A) krijoi “*trustin e trurit*”
- B) zgjeroi lirinë e organizimit sindikal
- C) krijoi “sistemin unik bankar amerikan”
- D) krijoi “administratën e përparimit në punë”

386. Republika e parë gjermane u krijua:

- A) nga konferenca e Versajës
- B) nga konferenca e Berlinit
- C) me kushtetuta e Bonit
- D) me kushtetutën e Vajmarit

387. Bazuar në kushtetutën e Vajmarit. Gjermania kishte si formë shtetërore:

- A) monarki kushtetuese
- B) perandori e centralizuar
- C) monarki absolute
- D) republikë

388. Programin politik të nazistëve Hitleri e prezantoi në librin e tij me titull:

- A) “Mainkamf”
- B) “Kulturkamf”
- C) “Raca Superiore”
- D) “Mbinjeriu”

389. Tipari kryesor i politikës së jashtme të Gjermanisë hitleriane ishte:

- A) nacionalizmi
- B) revanshizmi
- C) kolonializmi
- D) pacifizmi

390. Repartet ushtarake speciale te regjimit fashist në Itali ishin:

- A) “Falangat e zeza”
- B) “Naziskinet”
- C) “Këmishat e zeza”
- D) “Repartet SS”

391. Organizatat fashiste në Spanjë krijuan grupimin me emrin:

- A) “Falanga”
- B) “Këmishat e zeza”
- C) “ETA”
- D) “Anarkistët”

392. Me përfundimin e luftës civile të Spanjës u vendos në Spanjë:

- A) republika
- B) diktatura fashiste
- C) perandoria
- D) mbretëria

393. Politika e zbatuar nga bolshevikët gjatë luftës civile në Rusi u quajt:

- A) politika e re ekonomike
- B) politika popullore
- C) komunizmi i luftës
- D) socialkomunizmi

394. Politika e re ekonomike në Rusi parashikonte:

- A) shtetëzimin e ndërmarrjeve
- B) krijimin e kolkozeve
- C) të drejtën fshatarëve të shisnin tepricat pasi shlyenin detyrimet e shtetit
- D) detyrimin fshatarëve të dorëzonin tepricat në favor të shtetit

395. Veçori e zhvillimeve politike në Japoni pas Luftës I Botërore ishin:

- A) prirjet militariste në organet qendrore të shtetit
- B) prirjet progresiste demokratike në organet qendrore të shtetit

- C) zëvendësimi i drejtimit diktatorial me atë liberal
- D) prirjet për një legjislacion perëndimor

396. Me përfundimin e revolucionit qemalist Turqia u shëndrrua në:

- A) perandori despotike centraliste
- B) republikë parlamentare
- C) monarki kushtetuese
- D) monarki parlamentare

397. Organizata nacionaliste e formuar nga Qemal Ataturku për krijimin e Turqisë moderne ishte:

- A) “Organizata për mbrojtjen e të drejtave të Anadollit e Rumelisë”
- B) “Organizata Çlirimtare turke”
- C) “Organizata për Republikën turke”
- D) “Organizata për një Turqi moderne”

398. Bazuar në kushtetutën e 1919 shteti Serbo – Kroato – Slloven ishte:

- A) perandori
- B) republikë kushtetuese
- C) republikë presidenciale
- D) monarki parlamentare

399. Mbreti Aleksander e shpalli krijimin e monarkisë jugosllave në vitin:

- A) 1919
- B) 1918
- C) 1929
- D) 1920

400. Boshti i politikës së nazizmit gjerman ishte:

- A) krijimi i Gjermanisë së madhe
- B) vendosja e ekuilibrave dhe stabilitetit në Europë
- C) forcimin e Lidhjes së Kombeve
- D) paqja dhe rindërtimi i Europës

401. Anshlusi gjerman realizoi:

- A) bashkimin e krahinës së Sudeteve me Gjermaninë
- B) bashkimin e Austrisë me Gjermaninë
- C) pushtimin e Bohemisë nga Gjermania
- D) pushtimi i Moldavisë nga Gjermania

402. Dokumenti i parë i nënshkruar nga aleanca antifashiste me 14 gusht 1941 ishte:

- A) “Marrëveshja e Atlantës”
- B) “Blloku i Perëndimit”
- C) “Karta e Atlantikut”

D) “Aleanca e Perëndimit”

403. “Karta e Atlantikut” e vitit 1941 vendosi:

- A) të mos njohë pushtimet fashiste dhe ndryshimet e hartës politike të Europës
- B) të njohë pushtimet e Gjermanisë fashiste
- C) të njohë pushtimin e BS nga Gjermania
- D) të njohë pushtimet e Japonisë në Azinë Juglindore

404. Konferenca e Jaltës vendosi:

- A) ndarjen e Gjermanisë në katër zona pushtimi
- B) lufta me Gjermaninë të përfundojë vetëm me pushtimin e Gjermanisë
- C) shkatarrimin e plotë të industrisë ushtarake gjermane
- D) ekzekutimin e drejtuesve kryesorë nazistë

405. Konferenca e Potsdamit vendosi:

- A) krijimin e OKB
- B) që Bashkimi Sovjetik të hynte në luftë kundër Japonisë
- C) dënimin e kriminelëve të luftës
- D) lufta me Gjermaninë do të marrë fund vetëm me pushtimin e Gjermanisë

406. Konferenca për krijimin e OKB në vitin 1945 ishte konferenca e:

- A) Parisit
- B) Potsdamit
- C) Gjenevës
- D) San Françiskos

407. Organizata evropiane për menaxhimin e ndihmave amerikane në Europë ishte:

- A) “Organizata Evropiane e Kooperimit Ekonomik”
- B) “Tregu i Përbshkët European”
- C) “Komuniteti ekonomik Evropian”
- D) “Bashkimi Evropian”

408. Politika konfrontuese e garës së armatimeve midis dy blloqeve pas Luftës II Botërore quhej:

- A) lufta e ftohtë
- B) gara paqësore
- C) lufta e yjeve
- D) lufta e tregjeve

409. Ndihma amerikane për Greqinë dhe Turqinë e mbështet në:

- A) “Doktrinën Truman”
- B) “Planin Marshall”
- C) “Doktrinën Monro”
- D) “Kursin e ri”

410. Programi i posaçëm amerikan për rimëkëmbjen ekonomike të vendeve europiane ishte:

- A) plani Truman
- B) plani Marshall
- C) kursi i ri
- D) kursi i kufirit të ri

411. Programi qeveritar amerikan i presidentit Kenedi u quajt:

- A) kursi i ri
- B) sistemi i ri ekonomik
- C) kursi i kufirit të ri
- D) ristrukturimi ekonomik amerikan

412. Politika e ndjekur nga presidenti amerikan Kenedi ishte politikë:

- A) e diskriminimit racial
- B) e zhdukjes së dallimeve raciale në votim, arsim, punësim e mjedise publike
- C) politikë konservatore shfrytëzuese
- D) e largimit nga aparati shtetëror i personaliteteve zezake

413. Programi i ndjekur nga presidenti amerikan Regan u quajt:

- A) kursi neokonservator
- B) kursi i ri
- C) riorganizimi i ri ekonomik
- D) kursi i kufirit të ri

414. Detyrimi i Gjermanisë pas Luftës II Botërore ishte:

- A) ndalimi i formimit të partive të reja politike
- B) kufizimi i zhvillimit ekonomik të Gjermanisë
- C) likuidimi i forcave të armatosura gjermane dhe industrisë së luftës
- D) kufizim i pjesmarrjes së Gjermanisë në organizatat ndërkombëtare

415. Me kushtetutën e Bonit të vitit 1949 Gjermania u ndërtua si:

- A) republikë parlamentare
- B) republikë presidenciale
- C) monarki kushtetuese
- D) monarki parlamentare

416. Dhoma e ulët në parlamentin e sotëm gjerman emërtohet:

- A) bundestagu
- B) bundestrati
- C) raishtagu
- D) raistrati

417. Dhoma e lartë e parlamentit të sotëm gjerman bundestrati:

- A) zgjidhet me votim të drejtpërdrejtë
- B) përbëhet nga përfaqësues të landeve
- C) caktohet nga dhoma e ulët
- D) caktohet nga presidenti

418. Ostpolitika e kancelarit gjerman Vili Brand ishte politikë e:

- A) hapjes më lindjen
- B) konfrontimit me lindjen
- C) luftës së ftohtë midis dy gjermanive
- D) zgjerimit kolonial të Gjermanisë

419. Kursi i ri i reformave të Gorbaçovit në BS njihet me emrin:

- A) politika e re
- B) radikalizmi rus
- C) perestrojka
- D) Rusia e re

420. Sipas kushtetutës së vitit 1993 Rusia është:

- A) republikë presidenciale
- B) republikë parlamentare
- C) perandori
- D) monarki

421. Dhoma e lartë e parlamentit rus është:

- A) дума
- B) këshilli i federatës
- C) këshilli nacional
- D) asambleja kombëtare

422. Marrëveshja e vitit 1989 ndërmjet Solidarnostit e qeverisë polake vendosi:

- A) të pranonte zgjedhje të lira
- B) fillimin e privatizimit masiv
- C) heqjen e subvencioneve shtetërore
- D) krijimin e qeverisjes së parë jokomuniste në Europën Lindore

423. Solidarnosti ishte një lëvizje antikomuniste në:

- A) Çeki
- B) Hungari
- C) Rumani
- D) Poloni

424. Format tipike shtetërore që dominuan vendet e Amerikës Latine në vitet 50 – 60 ishin:

- A) diktaturat komuniste
- B) diktaturat ushtarake

- C) republikat demokratike
- D) sistemet monarkike

425. Konceptin “*Raison d`etat*” (çfarë bëhej për shtetin ishte bërë për Zotin) e përpunoi:

- A) Zhoze Fushe
- B) Zhak Bosie
- C) Rishëlie
- D) Mazarini

426. Merkantilizmi ishte teoria ekonomike e:

- A) feudalizmit
- B) absolutizmit
- C) liberalizmit
- D) fashizmit

427. Monarkia Franceze shënoi kulmin e zhvillimit të absolutizmit në kohën e:

- A) Luigjit XIII
- B) Luigjit XIV
- C) Luigjit XV
- D) Luigjit XVI

428. Lufta e Opiumit u zhvillua midis:

- A) Kinës dhe Anglisë
- B) Kinës dhe Japonisë
- C) Kinës dhe Indisë
- D) Kinës dhe Francës

429. Ndarja e Afrikës filloi si një proces i zyrtarizuar në konferencën e:

- A) Bandungut (1955)
- B) Potsdamit (1945)
- C) Berlinit (1884)
- D) Kazablankës (1943)

430. I mbiquajtur “*Xhorxh Uashingtoni i Amerikës Latine*” ishte:

- A) Joze San Martini
- B) Migel Idalgo
- C) Simon Bolivari
- D) Morelos

431. Kaudiljot ishin diktatorë në vendet e:

- A) Afrikës
- B) Azisë
- C) Amerikës Latine
- D) Amerikës Veriore

432. Propozimi për përfaqësim në kongresin e SHBA në raport me popullsinë u bë me planin:

- A) marshall
- B) truman
- C) njuxhersi
- D) virxhinia

433. Dhoma e ulët e kongresit amerikan është:

- A) dhoma e komunëve
- B) këshilli legjislativ
- C) dhoma e përfaqësuesve
- D) senati

434. Bazuar në kushtetutën e SHBA të 1787 pushteti ekzekutiv në SHBA ushtrohet nga:

- A) presidenti
- B) senati
- C) senati dhe presidenti
- D) kryeministri

435. Amandamenti XIX i kushtetutës së SHBA i viti 1920:

- A) hoqi skllavërinë në Amerikë
- B) caktoi kuota emigrimi
- C) shpalli të drejtën e përgjithshme të votimit
- D) reformoi kongresin amerikan

436. Sistemi i zgjedhjeve që zbatohet në SHBA është:

- A) mazhoritar
- B) proporcional
- C) i përzier
- D) proporcional – mazhoritar

437. Nga partitë e mëposhtme në Angli vepron partia:

- A) socialdemokrate
- B) laburiste
- C) kristiandemokrate
- D) demokrate

438. Një faktor që siguron alternimin në pushtet të dy partive në Angli është:

- A) rregulli i debatit
- B) rregulli i mandatit
- C) rregulli elektoral
- D) rregulli proporcional

439. Një ndër vendimet më të rëndësishme të reformës elektorale të vitit 1832 në Angli ishte:

- A) caktimi i kryeministrit nga partia fituese
- B) krijimi i kabinetit
- C) parimi i votbesimit të qeverisë në parlament
- D) reformimi i parlamentit me një dhomë

440. Bazuar në kushtetutën e 1958 në Francë presidenti zgjidhet nga:

- A) parlamenti
- B) dhoma e ulët
- C) senati
- D) një trup i gjerë elektorale

441. Kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjeve në Francë sipas kushtetutës së 1958 i përket:

- A) senatit
- B) këshillit kushtetues
- C) presidentit
- D) parlamentit

442. Origjina e fjalës “civilizim” vjen nga gjuha:

- A) greke
- B) latine
- C) sanskrite
- D) etruske

443. Në përmbajtjen e civilizimit perëndimor është:

- A) modernizmi
- B) qemalizmi
- C) reformizmi
- D) uesternizmi

444. Globalizmi është fenomen i:

- A) historisë së kohës së re
- B) historisë antike
- C) historisë së sotme
- D) historisë së mesjetës

445. Kuptimi i Sistemit të Demokracisë Liberale i referohet ekzistencës së:

- A) e drejtë vote universale, pjesëmarrje e lartë e shoqërisë civile, barazi para ligjit
- B) e drejtë vote universale, zgjedhje të lira, konkurruese, të rregullta e korrekte, më shumë se një parti politike, burime të ndryshme informacioni;
- C) e drejtë vote universale, barazi ekonomike, zhvillim i arsimit e shkencës;

D) e drejtë vote universale, shumë parti politike, përgjegjshmëri në vendimmarrje.

446. Elementet bazë të Konstitucionalizmit janë:

A) Kushtetuta e shkruar, barazia ekonomike, të drejtat sociale

B) Liritë e të drejtat e individit, mbrojtja e shtresave të pafavorizuara

C) Kushtetuta e shkruar, sundimi i ligjit, ndarja e pushteteve, garantimi i të drejtave individuale

D) Kushtetuta e miratuar nga një Asamble Kushtetuese, ekzistenca e organeve të kontrollit dhe garantimit kushtetues.

447. Thelbi i teorisë ekonomike të “*laissez – faire*” ka të bëjë me:

A) Nxitjen e të ardhurave doganore dhe fiskale

B) Nxitjen e marrëdhënieve tregtare midis kombeve duke lehtësuar detyrimet doganore

C) Mosdërhyrjen e autoriteteve shtetërore në veprimtarinë e lirë sipërmarrëse

D) Mosdërhyrjen e autoriteteve shtetërore për garantimin e rendit publik.

448. Konstitucionalizmi, ndarja e pushteteve dhe rishikimi gjyqësor ishin tri ndër arritjet e:

A) Revolucionit Amerikan

B) Revolucionit Francez

C) Nacionalizmit Modern

D) Postindustrializmit

449. Dukuria e Globalizimit karakterizohet nga:

A) Ndërvarësia ekonomike, rritja e numrit të transaksioneve, decentralizimi i prodhimit

B) Rritja e tarifave doganore, autonomia e politikave ekonomike

C) Ulja e shkëmbimeve tregtare, roli hegjemon i organizatave ekonomike ndërkombëtare

D) Përparësia e sektorit financiar dhe të shërbimeve, specializimi profesional

450. Tobin Tax synon të mbajë nën kontroll disa nga tiparet e globalizimit përmes:

- A) Uljes së taksave mbi shkëmbimet tregtare tregtare
- B) Lehtësimit të lëvizjes së njerëzve dhe mallrave
- C) Rritjes së taksave mbi transaksionet financiare
- D) Rritjes së taksave mbi shfrytëzimin e pronësisë intelektuale

KAPITULLI II

HISTORIA E POPULLIT SHQIPTAR

Pyetja 1.

Gjurmët më të hershme të qënies së njeriut në Shqipëri shfaqen në periudhën e:

- A) Mezolitit
- B) Musteriane
- C) Paleolitit të lartë
- D) Paleolitit të ulët

Pyetja 2. V)

Vendbanimi mezolitik i Konispolit II daton:

- A) 8500 vjet p.e.sonë
- B) 5800 vjet p.e.sona
- C) 7500 vjet p.e.sonë
- D) 5700 vjet p.e.sonë

Pyetja 3.)

Veglat prej bakri në Shqipëri u lindën në periudhën e:

- A) Eneolitit.
- B) Neolitit të hershëm.
- C) Neolitit të mesëm
- D) Mezolitit

Pyetja 4.

Vendbanimet palafite në Shqipëri janë zbuluar në stacionin arkeologjik:

- A) Cakran
- B) Konispol
- C) Maliq
- D) Tren

Pyetja 5.

Gjinia matriarkale arriti fazën e lulëzimit të lartë në periudhën e

- A) Bronxit
- B) Hekurit
- C) Mezolitit
- D) Neolitit

Pyetja 6.

Palafitet ishin vendbanime tipike:

- A) Mezolitike
- B) Eneolitike
- C) Neolitike
- D) Paleolitike

Pyetja 7.

Riti i varrimit me djegje (urna) ishte kulturë:

- A) Dorike
- B) Egjeane
- C) Italike
- D) Panonike

Pyetja 8.

Cila nga këto kultura tipizon autoktoninë e qytetimit ilir?

- A) Glasinaci
- B) Fusha me Urna
- C) Halshtati
- D) Luzhica

Pyetja 9.

Vendbanimet karakteristike të kohës së hekurit në Ilirinë e Jugut ishin:

- A) Kalatë e fortifikuara me mure.
- B) Palafitet
- C) Vendbanimet fshatare
- D) Vendbanimet e fortifikuara me mure,

Pyetja 10.

“Gradina” ishte vendbanim karakteristik për qytetimin ilir të kohës së:

- A) Bronzit
- B) Gurit të mesëm
- C) Gurit të vonë
- D) Hekurit

Pyetja 11.

Prona private në Iliri u shaq me parë në:

- A) Bujqësi
- B) Blegtori
- C) Zejtari
- D) Këmbim

Pyetja 12.

Dyrrahu u themelua koloni helene më:

- A) 627 p.e.sonë
